

UDHËZIM
Nr. 1917, datë 1.9.2014

PËR PËRCAKTIMIN E TARIFËS SË SHËRBIMIT PËR KALIMIN ME AVION TË KUFIRIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

(Ndryshuar me udhëzimin nr. 19, datë 22.5.2020)

(I përditësuar)

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës dhe të nenit 11 të ligjit nr. 9975, datë 28.7.2008 “Për taksat kombëtare”, të ndryshuar, ministri i Financave dhe ministri i Transportit dhe Infrastrukturës

UDHËZOJNË:

1. Tarifat e shërbimit, për kalimin me avion të kufirit të Republikës së Shqipërisë, është 10 euro dhe paguhet nga udhëtari në momentin e blerjes së biletës, tek shoqëritë ajrore, pavarësisht vendit apo mënyrës së shitjes së biletës.

2. Tarifa e kalimit me avion të kufirit të Republikës së Shqipërisë është një pagesë e detyrueshme që bëhet për llogari të buxhetit të shtetit nga çdo udhëtar që del nga territori i Republikës së Shqipërisë në drejtim të destinacioneve jashtë, përveç rastit kur udhëtari është transit dhe nuk e kalon kufirin, por qëndron në ambientet e aeroportit deri në vazhdimin e udhëtimit të tij.

3. Shoqëria “Tirana International Airport” (TIA) caktohet agjent për mbledhjen e tarifës të kalimit me avion të kufirit të Republikës së Shqipërisë dhe ka përgjegjësitë e mëposhtme:

a) Të kryejë, në zbatim të Marrëveshjes së Koncesionit dhe këtij udhëzimi, të gjitha procedurat për regjistrimin e kësaj tarife në sistemin e IATA-s.

b) Të llogarisë shumën e tarifës kombëtare që duhet të paguhet në buxhetin e shtetit për çdo shoqëri ajrore, mbështetur në dokumentin e udhëtimit të pasagjerëve dhe në përputhje me vlerën e biletave të shitura, sipas pikës 1 të këtij udhëzimi.

c) Për zbatimin e paragrafit “b” të kësaj pike, TLA-ja detyrohet të rakordojë dhe të faturtojë brenda datës 5 të muajit pasardhës me secilën nga shoqëritë ajrore, tarifën 10 euro/pasagjer për kalimin me avion të RSH-së, për muajin paraardhës bazuar në dokumentin e udhëtimit të pasagjerëve për muajin paraardhës (biletën e udhëtimit).

TLA-ja mban aktin e rakordimit me secilën shoqëri ajrore ku evidentohet numri i pasagjerëve që kanë kaluar kufirin, numri dhe vlera e biletave të udhëtimit dhe llogaritjet për vlerën përkatëse të tarifës kombëtare që secila shoqëri ajrore detyrohet t’i paguajë TLA-s si agjent, person përgjegjës për llogaritjen, arkëtimin dhe transferimin në buxhetin e shtetit të kësaj të ardhure prej tarifës. Rakordimi do të merret i mirëgenë dhe do të konsiderohet i bërë me lëshimin e faturës nga TLA-ja për shoqëritë ajrore. Aktrakordimi i mbajtur dhe fatura e lëshuar nga TLA-ja për shoqëritë ajrore, përmban detyrimin e tarifës për të cilin TLA-ja si agjent është përgjegjës të llogarisë, të arkëtojë dhe të paguajë (të transferojë) në buxhetin e shtetit.

d) “d) Faturimet përpunohen mbi bazën e dokumentit të udhëtimit (biletave të udhëtimit) të pasagjerëve dhe këto dokumente arshivohen dhe janë në ruajtje nga TLA-ja.

e) Shoqëritë ajrore brenda datës 10 të të njëjtit muaj, paguajnë detyrimin për shumën e tarifës për t’u paguar sipas faturës dhe aktit të rakordimit me TLA-në, në llogarinë bankare të hapur për këtë qëllim nga TLA-ja, e cila e transferon atë në buxhetin e shtetit brenda datës 15 të muajit.

f) Shfuqizuar.

g) TLA-ja detyrohet të deklarojë dhe të transferojë, në llogarinë e drejtorisë rajonale tatimore ku është e regjistruar, brenda datës 15 të të njëjtit muaj për muajin paraardhës shumën e faturuar për shoqëritë ajrore, sipas “Formularit të deklarimit të tarifave kombëtare”, bashkëlidhur udhëzimit nr. 26, datë 4.9.2008 “Për taksat kombëtare”.

h) Shfuqizuar.

4. “Shoqëritë ajrore, të cilat kanë përgjegjësinë që të arkëtojnë prej pasagjerëve nëpërmjet shitjes së biletës tarifën e kalimit me avion të kufirit të Republikës së Shqipërisë dhe të transferojnë shumën e arkëtuar në llogarinë bankare të hapur për këtë qëllim nga TLA-ja, ngarkohen me detyrat e mëposhtme:

a) Pas kryerjes nga TIA, në përputhje me germën “a”, të pikës 3, të këtij udhëzimi, të regjistrimit në sistemin e IATA-s të tarifës, çdo shoqëri ajrore në momentin e shitjes së biletave, duhet t’i shtojë këtë tarifë vlerës së biletës, si dhe ta pasqyrojë në të vlerën e tarifës të kalimit me avion të kufirit të Republikës së Shqipërisë.

b) Të arkëtojnë tarifën e paguar nga udhëtarët, nëpërmjet shitjes së biletave ,si pjesë e çmimit të biletës.
c)) Të rakordojnë me TLA-në për tarifën e faturuar për muajin paraardhës, brenda datës 5 të muajit pasardhës dhe të transferojnë për llogari të TLA-së shumat e faturuara, brenda datës 10 të muajit.

d) Të mbajnë dokumentacionin përkatës për numrin e biletave të shitura, numrin e biletave të anuluar dhe shumat e kthyer paguesve të tarifës.

Degët, apo zyrtat e përfaqësimit në Shqipëri të shoqërive ajrore të huaja, janë përgjegjëse për përmbushjen e detyrave të përcaktuara me këtë udhëzim në përputhje me tagrin e dhënë në përfaqësim.

5. Mbi tarifat e shërbimit të përfshira në këtë udhëzim nuk aplikohet TVSH.

6. Për shërbimin e kryer, TIA mban 5% komision të llogaritur mbi masën e *tarifave që ka faturuar* dhe transferon në llogarinë e drejtorisë rajonale tatimore ku është e regjistruar *95% të shumës së faturuar*.

7. *Për mosrespektim nga TLA-ja të detyrimeve të përcaktuara në pikën 3 të këtij udhëzimi, zbatohen sanksionet e ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008, "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe nenit 10 të ligjit nr. 9985, datë 28.7.2008 "Për taksat kombëtare", i ndryshuar, si dhe të udhëzimeve në zbatim të tyre.*

8. *Shfuqizuar.*

9. Formulari i paraqitur nëaneksin bashkëlidhur, do të jetë në fuqi deri në informatizimin e sistemit të tarifave dhe unifikimin e formularit të deklarimit.

10. Ky udhëzim shfuqizon udhëzimin nr. 40, datë 24.12.2008 "Për përcaktimin e tarifës së shërbimit për kalimin me avion të kufirit të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.

Ky udhëzim hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I TRANSPORTIT DHE
INFRASTRUKTURËS
Edmond Haxhinasto

MINISTRI I FINANCËVE
Shkëlqim Cani

ANEKS

Formulari i deklarimit

TARIFA PËR KALIMIN ME AVION TË KUFIRIT TË REPUBLIKËS, SË SHQIPËRISË

Deklarim për agjentin TIA

1. Shoqëri ajrore të huaja rezidente
2. Shoqëri ajrore të huaja jo rezidente
3. Shoqëri ajrore vendase

Faturime	Shume tarifës

TOTALI

Administratori:
(emër, mbiemër)
nënshkrimi